



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2025

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri Bashkia Mat
Adresa Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel
Tel/Fax 0685086246
E-mail eduart.abazi@gmail.com
Faqja e Internetit www.bashkiamat.gov.al

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **“Shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale”**. Data e zhvillimit do të jetë **12/02/2025, ora 15:00** në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi (Pa TVSH)
1.	<i>Shërbime publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale</i>	Muaj	12	
Shuma				
T.V.SH 20%				
Shuma Totale				

• **Shërbimi duhet të ketë këto specifikime teknike:**

- Në lidhje me shërbimin Media lokale, njoftime të ndryshme për periudhën 12 (dymbëdhjetë) muaj:
- Pasqyrimi i investimeve, aktiviteteve, takimeve zyrtare dhe reklamimeve nga ana e Bashkisë Mat dhe transmetim në TV. Gazetari përfaqësues i Medias Lokale duhet të mbajë kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e zyrës së shtypit në Bashkinë Mat. Ofruesit të shërbimit do t'i duhet të mbajë kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesen e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun*

për çdo nevojë të ndonjë: njoftimi, prononcimi reklamimi sipas nevojave të institucionit, shërbimi i këtyre pasqyrimeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Mat. Sipas nevojës së institucionit të Bashkisë Mat të mundësohet rikthimi i ndonjë kronike të pasqyruar në medja lokale gjatë vitit në CD, apo USB, si investime, aktivitete, takimeve sipas rasteve që mund të kemi duke ju referuar kontratës së lidhur midis palëve. Shërbim fotografie, video dhe video editim profesional si dhe montazhi i tyre për gjatë vitit kalendarik 2025.

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda 24 orësh nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dhe do të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

1. Formularin e Ofertës.

2. Vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës Nr. Extra “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”;

3. Ekstrakti Historik të QKB-s.

4. IBAN nga Banka.

5. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**

6. Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2024 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

7. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore, jo më herët se data e publikimit të procedurës.

8. Liçencë për ushtrimin e veprimtarisë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

9. Çertifikatë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e rrjetit për transmetim audio dhe/ ose audiovizive sipas Ligjit Nr.97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

*** Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.**

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë: 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate/ dorëzimin e faturës tatimore duhet të ketë:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave;
- Kopje të Çertifikatës Elektronike të Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerik.

KRITERET E PJESËMARRJES

Sipas Ftesës për Ofertë.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT

- Çmimi më i ulët.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR